



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 308 / prot.
8

Elbasan, më 15.12.2023

VENDIM

Nr. 45 datë 15.12.2023

**“PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT PËR
MATEMATIKË-INFORMATIKË ME PROFIL MINOR FIZIKË NË PROGRAMIN E
STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NE MËSUESI PËR MATEMATIKË- TIK NË
DEPARTAMENTIN E METODOLOGJIVE TË MËSIMDHËNIES NË FAKULTETI I
SHKENCAVE TË EDUKIMIT”**

Bazuar në Ligjin. Nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, germa “b”; nenin 35, pika 9, neni 38, pika 1, germa”dh” në Urdhrin nr. 225, datë 07.05.2018 të Ministrit të arsimit “Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë”, në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL”, Kreu IV si dhe në Udhëzimin nr.10, datë 30.03.2020 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit riorganizimin e programit të studimit Master profesional në “Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për matematikë-fizikë me profil minor fizikë” në programin e studimit Masteri shkencave në “Mësuesi për Matematikë -TIK”.
2. Diploma ekzistuese Master profesional në “Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për matematikë-informatikë me profil minor fizikë” të bëhet **Master i shkencave në “Mësuesi për Matematikë-TIK”**.
3. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në Mësuesi për Matematikë-TIK (modeli bashkëngjitur).
4. Ky vendim t’i përcillet, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për procedura të mëtejshme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI**